



Datë: 11.08.2025
Numër Protokolli: 5451/2025

A.nr.1283/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës–Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosijen e Ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Malsore Gashi Bajraktari dhe Eshref Shabani, anëtarë, me Flakron Gashi- në cilësinë e procesmbajtësit ka shqyrtuar ankesën A.nr.1283/2025, të datës 03.07.2025, të parashtruar nga ankuesi A.L, nga Podujeva , kundër Njoftimit të datës 15.05.2025 të Njesisë së Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Punëve të Brendshme, në çështjen juridike “kontestim konkursi”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180, si dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 11.08.2025 mori:

V E N D I M

Hedhet poshtë si e jashtëafatshme ankesa A.nr.1283/2025, e datës 03.07.2025 e parashtruar nga ankuesi A.L.

A r s y e t i m

Nëpunësi civil, A.L (në tekstin e mëtejme referuar: Ankuesi), me datë 01.07.2025 përmes postës ka parashtruar ankesë, e cila në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, është pranuar me datë 03.07.2025 dhe regjistruar me numër protokolli 4486/2025 nën shenjën A.nr.1283/2025, kundër procedurës së rekrutimit të shpallur nga Ministria e Punëve të Brendshme “Zyrtar për regjistrimin e automjeteve - Podujevë”,

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejme referuar: Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave, me datën 14.07.2025 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek MPB, ndërsa kjo e fundit me datë 18.07.2025, ka dorëzuar përgjigjen në ankesë lidhur me procedurën në fjalë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosijen e Ankesave (në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit) për vendosje meritore administroi këto prova: Ankesën të datës 03.07.2025 të parashtruar nga ankuesi në KPMSHCK; Njoftimin e datës 15.05.2025 të Njesisë së Burimeve

Njerëzore të MPB-së; Zarfën postar R8406520; Kërkesë për përgjigje në ankesë e datës 14.07.2025; Përgjigjen në ankesë e datës 17.07.2025; Konkursin e datës 14.02.2025; Listën e aplikantëve; Njoftimin për rezultatet e testit me shkrim; Njoftimin e datës 15.05.2025 për kandidatët e suksesshëm; Aplikacionin e kandidatit të suksesshëm G.O të datës 02.03.2025 me dokumentacionin e bashkangjitur; Aplikacionin e ankuesit të datës 26.02.2025 me dokumentacionin e bashkangjitur;

Kolegji i Këshillit, pas analizimit të shkresave të lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar se ankesa e ankuesit në këtë fazë **është e jashtëafatshme**, sepse:

Kolegji i Këshillit nga administrimi i shkresave të lëndës ka konstatuar se Ministria e Punëve të Brendshme, më datë 14.02.2025 ka shpallë konkursin me numër Reference RN00016697, për Grupi i administrimit të përgjithshëm, pozita e punës “Zyrtar për regjistrimin e automjeteve”, Qendra e Regjistrimit të Automjeteve në Podujevë, në kuadër të Agjencisë së Regjistrimit Civil/MPB, ku afati për aplikim ka qenë nga data 15.02.2025 deri më 16.03.2025, ndërsa nga shkresat e këndës arrihet në konstatimin se edhe ankuesi ka aplikuar në këtë konkurs.

Tutje, nga shkresat e lëndës rezultojnë se ankuesi, nuk e ka kaluar fazën e verifikimit paraprak, pasi që Njësia e Burimeve Njerëzore e Ministrisë së Punëve të Brendshme, i ka refuzuar aplikacionin me arsyetimin se i njëjti nuk kishte përmbushur kërkesat e përcaktuara si në konkursin e shpallur, ndërlidhur me përvojën e punës.

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshill, pretendon ankimor se i është refuzuar aplikacioni në mënyrë të kundërligjshëm për procedurën e rekrutimit sipas konkursit RN00016697 të datës 14.02.2025, me arsyetimin se i plotësojë kriteret e përcaktuara të konkursit që lidhen me përvojën e punës dhe kualifikimin arsimor.

Kolegji i Këshillit lidhur me këtë çështje juridike administrative, sa i përket procedurave të pranimit lidhur me pranueshmërinë e ankesës së ankueses mori për bazë dispozitat e nenit 27 Paragrafi 4 të Ligjit nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik , i cili përcakton se: “4. E drejta e ankimit në KPMSHCK i njihet edhe çdo kandidateje/i në procedurë pranimi në shërbimin civil”, si rrjedhojë meqenëse ankuesi konteston procedurën e rekrutimit që ndërlidhet me fazën e verifikimit paraprak, atëherë Kolegji i Këshilli konstaton se mënyra e parashtrimit të ankesës lidhur me procedurat e pranimit në Shërbimin Civil është rregulluar me nenin 39 paragrafi 12 të Ligjit nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik i cili përcakton se: “Kandidatët/ët e pakënaqur me procesin e rekrutimit, **pas shpalljes së rezultateve përfundimtare kanë të drejtë ankese në KPMSHCK sipas afatit të përcaktuar në ligjin përkatës për procedurën administrative.**”, dhe me nenin 17 Rregullore Nr. 15/2023 për Procedurën e Pranimit Në Shërbimin Civil, është përcaktuar se: “Kandidatët e pakënaqur me procesin e rekrutimit, **pas shpalljes së rezultateve përfundimtare kanë të drejtë ankese në KPMSHCK në afat prej tridhjetë (30) ditëve**”.

Kolegji i Këshillit duke marrë parasysh provat e lëndës si dhe duke ju referuara dispozitave të cekura si më lartë konstaton se ankuesi ankesën e datës 03.07.2025 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për

Shërbim Civil kundër shpalljes së rezultateve të përfundimtare sipas Njoftimit të datës 15.05.2025 për kandidatin e suksesshëm, e ka bërë jashtë afati kohor të përcaktuar me dispozitat e ligjit material, respektivisht nenit 39 paragrafi 12 të Ligjit nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik ndërlidhur me nenin 17 Rregullore Nr. 15/2023 për Procedurën e Pranimin Në Shërbimin Civil, si dhe në kundërshtim edhe me nenin 127 paragrafi 1 i Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ku përcaktohet se: “1. Ankesa duhet të parashtrohet brenda tridhjetë (30) ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ”, ndërsa nga shkresat e lëndës konfirmohet fakti se Njoftimi për kandidatin e suksesshëm i datës 15.05.2025 i Njesisë së Burimeve Njerëzore është publikuar me datë 15.05.2025.

Bazuar si me sipër si dhe duke ju referuar provave të lëndës Kolegji i Këshillit konstaton se ankesa e ankuesit e datës 03.07.2025 e parashtruar ne Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil, është e jashtëafatshme sikurse përcaktohet me dispozitat e nenit 127 paragrafi 1 të Ligjit nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, sepse e njëjta është parashtruar jashtë afatit prej 30 ditësh ndaj aktit të datës 15.05.2025, respektivisht njoftimit përfundimtar të procedurës së rekrutimit.

Theksuar si me lart, Kolegji i Këshillit duke u bazuar ne nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180, dhe nenin 129 paragrafi 1, nën paragrafi 1.3 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij Vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda, A.nr.1283/2025, datë 11/08/2025.

Flakron GASHI

Procesmbajtës

Arben MEHMETI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit A.L;
- Ministrisë së Punëve të Brendshme (Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore), si dhe;
- Arkivit të KPMSHCK-së.